



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17 regjistër (JR)
Datë 21.05.2024

Nr. 95 i vendimit
Datë 17.12.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e mërkurë, datë 17.12.2025, në orën 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 17/2024 (JR), datë 21.05.2024, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi përfaqësuesin e

Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorin Klodjan Braho¹, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi dhe avokaten e tij Romina Zano, që përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Nushi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë², me konstatimet se:
 - (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. AKSIK-u, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 30.11.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. 351, datë 18.11.2022, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi*.
 - 2.3. KLP-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar, në zbatim të

¹ Sipas autorizimit “Për përfaqësimin e çështjes në seancë publike” nr. {***} prot., datë 27.11.2025.

² ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.10.2018, ka përcjellë në Komision, “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Dritan Nushi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 735, datë 31.01.2024, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë.
4. Komisioni e ka mbështetur vendimin e mësipërm në konkluzionet e arritura mbi të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar për secilin prej tyre, si vijon.

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë⁴: *“Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, duke marrë në konsideratë rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur me të, krijimin e disa pasurive në periudhën para fillimit të detyrës dhe para lidhjes së martesës së subjektit, si dhe duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se:*

- Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka deklaruar saktësisht e plotësisht në këtë deklaratë pasuritë e tij, të personave të lidhur me të dhe të personave të tjerë të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

- Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruar dhe nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht.

- Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka treguar një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016”.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës⁵: *“Nga hetimi i kryer, Komisioni nuk ngrit dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës”.*

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale⁶: *“Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLP dhe dokumentacionit bashkëlidhur raportit të hartuar nga AKSIK-u, dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe*

³ KLP-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.01.2023, ka përcjellë në Komision “Raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi”.

⁴ Paragrafi 21, faqja 32 e vendimit të Komisionit.

⁵ Paragrafi 5, faqja 33 e vendimit të Komisionit.

⁶ Paragrafi 33, faqja 67 e vendimit të Komisionit.

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në cenimin e figurës së tij, në kuptim të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, prandaj subjekti i rivlerësimit paraqet përshatshmëri për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës, si dhe ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016”.

III. Shkaqet e ankimit

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ka paraqitur ankimin nr. {***} prot., datë 10.05.2024⁷, kundër vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi.
6. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se nga shqyrtimi i vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konkluzionet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e faktike, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
7. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin një nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.
8. Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4, pika 2 e nenin 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi.*
9. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë, referuar renditjes së tyre në ankim.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

⁷ Ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

11. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 04.12.2025, 16.12.2025 dhe 17.12.2025.
13. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
14. Në seancën gjyqësore publike të datës 04.12.2025, në parashtrimet e tij përpara Kolegjit lidhur me ankimin, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, deklaroi se u qëndron në parim shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit, pasi ankimi në rastin konkret evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit. Për rrjedhojë të sa më sipër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i qëndroi kërkimit të ankimit për ndryshimin e vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
15. Po në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit, në përfundim të parashtrimeve, i kërkoi Kolegjit të rrëzojë si të pabazuar në fakte dhe në ligj ankimin e Komisionerit Publik dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, si një vendim i bazuar në një shqyrtim të drejtë, të plotë dhe në përputhje me standardet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Së bashku me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen e tyre nga Kolegji në cilësinë e provave të reja, nëpërmjet çeljes së hetimit gjyqësor, me qëllim shqyrtimin e plotë të rrethanave faktike lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të atij profesional. Trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të depozituara në Kolegji nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet, përveç atyre të cilat ishin administruar gjatë hetimit administrativ dhe, për pasojë, ishin depozituar nga Komisioni në Kolegji.
16. Në lidhje me denoncimet e publikut⁸, në seancën gjyqësore publike të datës 04.12.2025, në vlerësim të parashtrimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këto

⁸ Në Kolegji janë depozituar: denoncime nga z. V. Ç., regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 08.10.2019; nr. {***} prot., datë 06.01.2020; nr. {***} prot., datë 24.12.2019; nr. {***} prot., datë 23.12.2019; nr. {***} prot., datë 20.04.2024 dhe nr. {***} prot., datë 06.06.2024; denoncim i z. S. H., regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 09.02.2024; denoncim i znj. Sh. A., regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 11.12.2024;

denoncime, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme parashtrori se ato nuk përmbajnë rrethana të tilla që do të mund të ndikonin në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje edhe të akteve të paraqitura prej tij lidhur me këto denoncime, parashtrori se pretendimet e denoncuesve nuk qëndrojnë, duke i kërkuar Kolegjit të mos i marrë në konsideratë. Në këto kushte, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vlerësoi se denoncimet e depozituara nga publiku nuk sjellin fakte dhe rrethana të cilat plotësojnë kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për të legjitimuar nevojën për hetime të mëtejshme. Për sa i përket denoncimit të paraqitur në Kolegj nga znj. L. E. B., trupi gjykues konstatoi se çështja për të cilën ka ngritur pretendime denoncuesja, është një çështje që vijon të jetë në hetim nga subjekti i rivlerësimit dhe, në këto kushte, bazuar në parashikimin e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ky denoncim do të jetë i panevojshëm të verifikohet edhe për shkak të parashikimit të kësaj dispozite.

17. Në seancën gjyqësore të datës 16.12.2025, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, deklaroi se në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara në cilësinë e provës dhe shpjegimeve të dhëna prej tij rezultoi se ka arritur nivel të besueshëm në të tri kriteret e vlerësimit, prandaj shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik nuk gjejnë mbështetje faktike dhe juridike. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

B/1 Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

18. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas së cilit *për procedimin penal nr. {***} të vitit 2015⁹, subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e çmuarjes drejt të provës, aktit të ekspertit teknik nr. {***}, datë 23.03.2015, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 96/2016”), trupi gjykues vëren si më poshtë.*

18.1. Komisioni ka hetuar mbi procedimin penal nr. {***}/2015, të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe në përfundim, në vendim¹⁰, ka konkluduar se: *Komisioni, pasi mori në shqyrtim prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vëren se në lidhje me analizën e elementeve të veprës penale që bën subjekti në prapësimet e tij, kjo i përket anës materiale të çështjes dhe për këtë Komisioni nuk ka kompetencë shqyrtimi dhe vlerësimi, referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Nga ana procedurale, Komisioni vlerëson se subjekti e ka çmuar aktin e ekspertimit në raport dhe në*

*denoncim i z. A. K., regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 24.06.2024 dhe nr. {***} prot., datë 14.10.2024; denoncim i z. A. A., regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.07.2022; denoncim i znj. L. E. B., i regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 14.11.2025.*

⁹ *Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të të dhënave të dokumentit ligjor nr. {***}, si një nga dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, referuar në rubrikën përkatëse të Raportit të KLP-së për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi, nr. {***} prot., datë 24.01.2023.*

¹⁰ *Paragrafët 17-19 të vendimit të Komisionit.*

harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, duke respektuar nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale “Çmuarja e provave”, për të arritur në konkluzionin nëse ka apo jo elemente të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Sa më lart, vlerësohet se subjekti ka dhënë argumente të mjaftueshme bindëse bazuar edhe në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë se për procedimin në fjalë nuk është bërë e mundur të provohet plotësisht tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” me të gjitha elementet e saj dhe, si rrjedhojë, çdo dyshim shkon në favor të pozitës së të akuzuarit. Për këtë arsye, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në veprimet e subjektit nuk rezultuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional.

18.2. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se vëren të meta në veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e procedimit penal me nr. {***}/2015, të cilat janë:

(i) Marrja e provave nga autoritetet e huaja nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, duke i bërë ato si rrjedhojë të papërdorshme.

(ii) Aktet e administruara në dosje të këtij procedimi penal, të marra nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk janë marrë në rrugën e duhur procedurale, fakt i cili është pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit për pushimin e çështjes, datë 19.05.2015.

(iii) Në hetimin e këtij procedimi penal, nuk i është kushtuar vëmendje marrëdhënieve juridiksionale me një shtet të tretë, siç është Turqia, autoritetet ligjzbatuese të së cilës e kanë kthyer shtetasin meksikan Z. R. M., pasi e kanë kategorizuar si person i kategorisë “INAD”, duke qenë se dyshohej se pasaporta e tij meksikane ishte e falsifikuar.

(iv) Aktit i ekspertimit teknik të pasaportës, nr. {***}, datë 23.03.2015, i Drejtorisë së Policisë Shkencore, me objekt pasaportën meksikane të z. Z. R. M., nuk është bazuar vetëm nga pamja vizuale e dokumentit, siç ka pretenduar subjekti në prapësimet e tij para Komisionit, por dokumenti objekt ekspertimi është ekzaminuar me mjete shkencore të përshtatshme, siç janë lente me shkallë të ndryshme zmadhimi, mikroskopsterioskopik binokular, me dritë të përqendruar, me fibra optike “Euromex”, si dhe aparatën video-spektral krahasues të kompjuterizuar VSC 2000.

18.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me këtë procedim penal.

18.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare prapësoi shkakun e ankimit, mbështetur edhe në aktet e paraqitura prej tij e të administruara në cilësinë e provës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

(i) Kanali formal i parashikuar nga riti i letërporosisë nuk mund të vihej në lëvizje, për mungesë mbështetjeje në një instrument kombëtar apo ndërkombëtar të aplikueshëm, rrjedhimisht përdorimi i kanaleve alternative të bashkëpunimit nuk mund të cilësohet si “jozyrtar” në kuptim diskualifikues, kur kanali zyrtar nuk ishte objektivisht i disponueshëm.

(ii) Materiali i ardhur nga autoritetet meksikane ka mbërritur në rrugë diplomatike, i përkthyer dhe i legalizuar nga Ambasada e Meksikës, në Romë dhe nga Konsullata e Meksikës, në Tiranë.

Paketa dokumentare është notifikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ka kaluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, më pas në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe në vijim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ky zinxhir i përcjelljes dhe autenticitetit rezulton i dokumentuar në dosjen hetimore.

(iii) Mënyra sesi është vepruar nga subjekti i rivlerësimit për çmuarjen e akt-ekspertimit teknik të pasaportës përputhet me standardin ligjor e metodologjik të kërkuar nga neni 152 i Kodit të Procedurës Penale. Akti i ekspertimit është vendosur në dialog analitik me provat e tjera, me origjinën dhe zinxhirin e administrimit të tyre, me koherencën e rrethanave faktike dhe me çdo alternativë shpjeguese të arsyeshme dhe vetëm pasi ky peshim i integruar nuk e tejkalonte pragun “te j çdo dyshimi të arsyeshëm” u mbërrit në përfundimin përkatës në respekt të parimit *in dubio pro reo*.

(iv) Në dritën e akteve të administruara rezulton se pasaporta në fjalë është lëshuar nga një autoritet konsullor kompetent jashtë territorit të Meksikës; dokumentacioni i ardhur zyrtarisht nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme vërteton se i njëjti person që u ndalua në vitin 2015 kishte aplikuar një vit më herët në konsullatën e San Bernardinos (Kaliforni) dhe e kishte përfituar pasaportën në rrugë ligjore; gjurmët e udhëtimit të pasqyruara në vulat kufitare tregojnë përdorim të rregullt të këtij dokumenti në disa shtete para mbërritjes në Shqipëri; deklaratimet dhe alibitë e të hetuarit janë në rezonancë me provat e administruara; dhe, më e rëndësishmja, verifikimet në sistemet policore dhe përmes INTERPOL-it nuk kanë nxjerrë asnjë skedim apo dyshim për veprimtari kriminale brenda ose jashtë vendit deri në çastin e vendimmarrjes për pushim.

18.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, vlerësoi se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkakut të ankimit dhe rrethanat e rastit mbetën të njëjta. Në procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit meksikan Z. R. M., subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në aspektin e çmuarjes drejt të provës, aktit të ekspertit teknik nr. {***}, datë 23.03.2015, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteri i parashikuar në pikën 3, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”).

- 19.** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas së cilit *për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2013¹¹, arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në pushimin e procedimit penal, duke e lidhur atë me juridiksionin civil, tregon për mangësi sipas përcaktimit të nenit 73 “Aftësia profesionale e prokurorit”, pika 2 e tij, aspekti për të ndërmarrë logjikisht hetimin, që duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren si më poshtë.*

19.1. Komisioni ka hetuar mbi procedimin penal nr. {***}/2013, të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe në përfundim, në vendim¹², ka konkluduar se: *Në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, referuar nenit 186/3 dhe nenit 66, shkronja “c” e Kodit Penal, qëndron prapësimi i subjektit të rivlerësimit se afati i ndjekjes penale për këtë veprë penale është parashikuar, si dhe referuar akteve të administruara në dosjen hetimore dhe akteve*

¹¹ *Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimit nr. {***} prot., datë 15.03.2018, të znj. F. M. (B.).*

¹² *Paragrafi 26 i vendimit të Komisionit.*

bashkëlidhur denoncimit, nuk mund të hetonte për një kallëzim, i cili nuk ishte regjistruar në regjistrat e prokurorisë. Në lidhje me veprën penale “Ekspertimi i rremë”, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes civile dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile që përshkruan subjekti në prapësime, Komisioni vlerëson se këto prapësime janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen se subjekti ka marrë një vendim të drejtë, të bazuar në dispozitat procedurale penale dhe ato procedurale-civile që lidhen me procesin penal. [...] Në denoncim, denoncuesja ka pretenduar se procedimi është pushuar pa u kryer asnjë hetim. Nga ana tjetër, sipas akteve në dosje, Komisioni ka konstatuar se janë kryer mjaft veprime hetimore, sidomos nga prokurori paraardhës Z. H.. [...] Subjekti ka marrë vendimin, datë 03.03.2014, për “Pushimin e procedimit penal”, pasi ka administruar shkresën datë 24.02.2014, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që konfirmon se procesi gjyqësor është në shqyrtim, në pritje për t’u kryer akti i ekspertimit për kundërpadinë, i cili nuk ishte kryer ende, për shkak se palët nuk kishin vënë në dispozicion të ekspertit provat e kërkuara prej tij. Në këto kushte, kur gjykata civile nuk kishte marrë vendim për të administruar provat e paraqitura në gjykim, përfshirë këtu edhe aktet e ekspertimeve, për të cilat ende nuk kishte dhënë një vlerësim, subjekti nuk mund të hetonte për aktin e ekspertimit dhe kontratën e dhurimit, për vlefshmërinë e të cilave nuk ishte shprehur ende kjo gjykatë. Për sa më lart, nën dritën e neneve 272, 273, 274 e 275 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 70 e 71 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni arrin në përfundimin se nuk rezulton të ketë mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.

19.2. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit, duke vlerësuar se në konsideratë të rëndësisë së arsyetimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor, arsyetimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit, duket se është në kushtet e mungesës së një argumentimi ligjor, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. {***/2013, nuk janë bindëse, pasi shkaku që përdor subjekti i rivlerësimit në vendimin e pushimit të procedimit, se nuk është mbyllur gjykimi civil me objekt goditje të kontratës për falsitet, nuk gjen referencë ligjore. Subjekti i rivlerësimit duket se në mënyrë të gabuar vlerëson kompetencën e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale krahasuar me kompetencën e gjykatës civile, pasi gjykata gjykon për pavlefshmëri kontrate për shkak falsifikimi, i cili do të provohej nëpërmjet aktit të ekspertimit, ndërsa organi i akuzës duhej të hetonte për faktin nëse ky akt-ekspertimi është apo jo i rremë dhe këtë hetim nuk mund ta kryejë gjykata në një proces civil, por vetëm organi i akuzës. Pra, në rastin konkret, hetimet penale nuk vareshin nga gjykimi civil. Edhe sikur hetimi penal të varej nga gjykimi civil, nisur nga fakti që në kallëzim dhe në shtesën e kallëzimit, është kërkuar ndjekja penale ndaj noteres Sh. K. edhe për falsifikimin e dëshmisë së trashëgimisë nr. {***}, datë 17.04.1990, që nuk ka qenë objekt i ekspertizës së ekspertit I. Sh., atëherë subjekti i rivlerësimit nuk kishte pse të kushtëzonte kryerjen e hetimit penal për të provuar falsifikimin e dëshmisë së trashëgimisë, e cila nuk po gjykohej për falsitet në procesin civil. Subjekti i rivlerësimit, duket se ka kanalizuar të dhënat e kallëzimit drejt konfliktit civil dhe nuk ka konsideruar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale, edhe pse në rastin konkret proceset gjyqësore të zhvilluara pranë gjykatave civile nuk kanë pasur objekt padie “goditjen e akteve për falsitet”, duke mos i dhënë zgjidhje konfliktit të palëve, që duket se

vazhdon me të njëjtat rrethana dhe shumë kohë pas vendimit të mosfillimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit.

19.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me këtë procedim penal.

19.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare prapësoi shkakun e ankimit, mbështetur edhe në aktet e paraqitura prej tij e të administruara në cilësinë e provës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

Vendimi i pushimit të procedimit është mbështetur në parimin e ekonomisë së procesit dhe në rregullat që qartësisht i njohin gjykatës civile kompetencë të drejtpërdrejtë për të shqyrtuar pretendimin e falsitetit të një akti të paraqitur si provë në atë proces. Në fazën kur u mor vendimi i pushimit, çështja civile për pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit ishte në shqyrtim aktiv, me ekspertim shkencor të administruar nga gjykata dhe pa një konstatim gjyqësor apo provë shkencore që të vërtetonte falsitetin. Në këto kushte, qëndrimi i prokurorit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor civil nuk është shmangie nga ndjekja penale, por ushtrim i kujdesshëm i diskrecionit procedural për të evituar dyshime hetimi dhe përfundime potencialisht kontradiktore, në përputhje me nenin 328, pika 1, shkronja “f” dhe nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale. Duke iu referuar kronologjisë së veprimeve të kryera, në përputhje me veprimet procedurale para gjykatës, nuk u evidentuan elemente përbërëse të veprës penale të “Ekspertimit të rremë”, sipas nenit 309 të Kodit Penal. Nga vendimi civil nr. {***}, datë 05.05.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditëse F. M. (B.), të paditur B. B. dhe të tjerë, palë të treta noterja Sh. K. dhe {***}-ja Tiranë në mungesë, rezulton se janë shqyrtuar kërkimet për detyrim njohjeje të së drejtës së pronësisë së paditëses mbi ¼ e pasurisë trashëgimore, si dhe kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.1990 dhe në përfundim gjykata ka vlerësuar si të ligjshme mënyrën e fitimit të pasurisë nga S. B. nëpërmejt kontratës së dhurimit, si dhe vlefshmërinë e disponimit pasues me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.03.1991, në favor të B. B.. Për pasojë, padia është rrëzuar si e pabazuar në prova dhe në ligj. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Ky përfundim gjyqësor konfirmon se pretendimi i denoncuesve për falsitet nuk u vërtetua as në juridiksionin civil, gjë që mbështet vlerësimin e prokurorit se nuk ekzistonin prova të mjaftueshme për ndjekje penale. Vendimi i pushimit nuk përmban asnjë referencë specifike për dëshminë e trashëgimisë nr. {***}, datë 17.04.1990, të lëshuar nga noterja Sh. K., pasi subjekti e ka vlerësuar këtë pretendim si të papërshtatshëm për hetim penal për arsye që lidhen me natyrën juridike të dokumentit dhe me kufijtë e parashkrimit. Ky vlerësim hyn brenda diskrecionit të prokurorit për të përcaktuar objektin e hetimit në bazë të elementeve fillestare të kallëzimit dhe të bazës ligjore për ndjekjen penale.

19.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2013, duke e lidhur atë me juridiksionin civil, tregon për mangësi, sipas përcaktimit të nenit 73 “aftësia profesionale e prokurorit”, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, aspekti për të ndërmarrë logjikisht hetimin.

20. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas së cilit për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2018¹³, veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, në drejtim të respektimit të të drejtave të viktimave dhe regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, tregojnë për mangësi, sipas përcaktimit të nenit 73 “Aftësia profesionale e prokurorit”, pika 2 e tij, aspekti për të ndërmarrë logjikisht hetimin dhe duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren si më poshtë.

20.1. Komisioni, në përfundim të hetimit lidhur me procedimin penal nr. {***/2018, ka vlerësuar, në vendim¹⁴, se: [...] Në lidhje me zvarritjen e hetimeve, provohet pretendimi i subjektit se gjatë hetimit është vonuar nga ekspertët kryerja e aktit të ekspertimeve përkatëse (me vendimin datë 03.06.2018, subjekti ka vendosur kryerjen e ekspertimit mjekoligjor dhe akti i ekspertimi është dërguar në Prokurori, në datën 17.10.2018, pra, 4.5 muaj më vonë nga data e vendimit; me vendimin datë 02.08.2018 është vendosur kryerja e ekspertimit autoteknik dhe akti ka ardhur në Prokurori në datën 07.10.2018, pra, 2 muaj më pas). [...] duke mbajtur në konsideratë faktin që, pavarësisht vonesës pa pasoja të hetimit, sërish hetimi është kryer brenda afatit të përgjithshëm procedural prej 2 vjetësh nga data e regjistrimit të tij; duke mbajtur në konsideratë faktin që ndaj vendimit të pushimit të hetimit nga subjekti pas riçeljes së hetimit, kallëzuesi nuk ka bërë ankim-vlerëson që në vështrim të përgjithshëm veprimet e subjektit për vonesën e hetimit të pretenduar nga denoncuesja nuk përbëjnë vonesa esenciale rënduese për pozitën e kallëzuesit dhe nuk janë të një rëndësie thelbësore për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, aq më tepër që nga përmbajtja e dosjes rezulton që veprimet hetimore të jenë kryer në vazhdimësi, në linjë kronologjike logjike dhe në intervale kohore të pranueshme. Denoncuesja ka pretenduar se subjekti ka zvarritur hetimet për 7 muaj pa disponuar me vendime për shtyrje të afatit. Komisioni sjell në vëmendje se sipas parashikimeve të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, brenda afatit të përgjithshëm 2-vjeçar, hetimet zgjasin deri 3 muaj nga data kur regjistrohet emri i personit që i atribuohet vepra penale e, më pas, zgjatja e afatit të përfundimit të hetimeve bëhet çdo tre muaj. Në rastin e procedimit penal të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton që procedimi penal është regjistruar pa emër të autorit të veprës penale, kështu që subjekti nuk mund të dispononte me vendime për shtyrje të afatit të hetimeve. Në lidhje me informimin e palës së dëmtuar, Komisioni sjell në vëmendje se neni 58, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, përcakton detyrimin e organit procedues që të njoftojë menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe të mbajë procesverbal për këtë njoftim; neni 110, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, përcakton detyrimin që organi procedues të shprehet me vendim brenda 15 ditëve për kërkesat dhe memot e depozituara nga palët. Pra, referuar këtyre dispozitave, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që për çdo kërkesë apo memo të palës së dëmtuar të shprehej me shkrim, duke bërë kështu transparente veprimet e tij procedurale dhe marrëdhëniet me palët në proces. Për sa më lart, Komisioni vlerëson se bazuar në shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, prapësimet e tij në lidhje me konstatimin e Komisionit se

¹³ Procedimi penal është analizuar nga Komisioni, në kuadër të denoncimit nr. {***} prot., datë 13.03.2019, të znj. A. C.. Denoncuesja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin për 7 muaj pa vendime të shtyrjes së afateve hetimore, ka vendosur pushimin e çështjes duke anashkaluar provat dhe pa hetuar dokumentet që i ka vënë në dispozicion kallëzuesi dhe ato që ka marrë vetë kryesisht, nuk i është përgjigjur kërkesave të kallëzuesit, për informacion mbi zhvillimin e hetimeve.

¹⁴ Paragrafët e vendimit të Komisionit.

“Subjekti ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer hetime të plota”, janë në tërësi bindëse dhe Komisioni nuk mund ta ngarkojë subjektin me përgjegjësi për veprimet e kryera në afatet e dokumentuara në dosje. Nga ana tjetër, në lidhje me konstatimin se subjekti nuk u është përgjigjur kërkesave procedurale dhe memove të kallëzuesit, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka cenuar të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, që të njihet me hetimin dhe materialet hetimore dhe nuk u është përgjigjur kërkesave dhe memove të tij, të drejta këto që parashikohen nga neni 58, pikat 1/d e 1/dh dhe nenet 105, 110 e 279/a të Kodit të Procedurës Penale, por, parë kjo nën dritën e një vlerësimi proporcional dhe objektiv, që ka të bëjë me këtë procedim në tërësi, veprimet hetimore procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, vendimmarrjet e tij dhe ato të gjykatës, si dhe nisur nga fakti që vendimi përfundimtar i pushimit i marrë nga subjekti i rivlerësimit ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga ana e kallëzuesit, Komisioni arrin në përfundimin se kjo problematikë nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional.

20.2. Komisioneri Publik, në argumentimin e shkaktuar të ankimit, sipas paragrafit 20 më sipër në këtë vendim, ka parashtruar se ndërsa mban qëndrim të njëjtë lidhur me përfundimin e arritur nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ka cenuar të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, ndan qëndrim të ndryshëm lidhur me afatet e hetimit në këtë procedim penal, të ndërlydhura këto me momentin e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet kryerja e veprës penale. Sipas Komisionerit Publik, për sa kohë që targa e automjetit është identifikuar nga vetë viktima, ishin kryer veprime nga ana e efektivëve të Policisë së Shtetit, menjëherë pas ngjarjes, e, në këto kushte, regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale, sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, duhej të bëhej nga subjekti i rivlerësimit krahas regjistrimit të procedimit penal.

20.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me këtë procedim penal.

20.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi shkaktuar të ankimit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se deri në datën e regjistrimit të procedimit penal nuk ekzistonte asnjë referim apo njoftim i policisë rrugore për një ngjarje të tillë. Në kallëzimin e tij, z. A. C. nuk sqaroi bazën provuese të identifikimit të drejtuesit të mjetit. Në këto kushte, afatet dhe aktet e zgjatjes, sipas neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, lidhen me momentin kur individualizohet emri i personit, gjë që nuk kishte ndodhur ende. Për pasojë, qasja e ndjekur nga prokurori ishte në përputhje me rregullat e procedimit dhe me kërkesën për një bazë provuese të mjaftueshme para se të formalizohet cilësia e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Pas dërgimit të çështjes në gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 18.12.2018, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, urdhëroi kthimin e akteve dhe vijimin e hetimeve, duke përcaktuar detyra të reja hetimore. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Edhe pse vendimi mori formë të prerë më datë 04.02.2019, dosja fizike u rikthye në prokurori vetëm më 13.03.2019. Ndërkohë që kallëzuesi paraqiti kërkesa për përjashtimin dhe zëvendësimin e prokurorit të çështjes. Kjo kronologji tregon se administrimi i të drejtave të palëve dhe komunikimi procedural janë zhvilluar brenda kufijve të sekretit hetimor dhe të rregullave të kompetencës. Pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme dhe të atyre të urdhëruara nga gjykata, si dhe në

dritën e provave të grumbulluara, vlerësimi mbeti i njëjtë, se nuk ishin përmbushur elementet e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, sipas nenit 290, paragrafi 2 i Kodit Penal. Kjo dispozitë kërkon që shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor të ketë shkaktuar plagosje të rëndë të një personi, ndërkohë që akti i ekspertimit mjekoligjor ka kategorizuar dëmtimet e të dëmtuarit si plagosje e lehtë. Për më tepër, lidhja shkakësore e domosdoshme mes sjelljes së drejtuesit të mjetit dhe pasojës penale të tipizuar nuk rezultoi e provuar, pasi shkakua përcaktues është sjellja e këmbësorit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës pushimin e çështjes penale dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {***}, datë 18.07.2019, vendosi pushimin e hetimeve dhe ky vendim mori formë të prerë, pa u ankimuar.

20.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mosregjistrimin e emrit të personit që i atribuohet kryerja e veprës penale në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, referuar akteve në dosje, janë të drejta dhe duhet të pranohen. Sa i përket mënyrës së përfundimit të këtij procedimi penal, nuk u konstatuan parregullsi, nisur dhe nga fakti që kërkesa e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2018, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 18.07.2019, ka vendosur pushimin e hetimeve, vendim i cili ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar.

- 21.** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas së cilit *për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2013¹⁵, subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi që bien nën veprimin e nenit 74, “Aftësitë organizative”, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, të cilat duhen marrë në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren si më poshtë.*

21.1. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, në vendim¹⁶, ka konkluduar se *duke iu referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe përmbajtjes së vendimit të tij për pushimin e procedimit penal nr. {***}, viti 2013, nga ku rezultoi se ka kryer hetimet e nevojshme dhe të gjithanshme dhe ka pasqyruar në vendim çdo veprim procedural dhe provë që ka administruar, vendimi është i kuptueshëm dhe me strukturë të qëndrueshme, por duke iu referuar edhe parashikimeve të pikave 3 dhe 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.*

21.2. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke parashtruar se hetimi i kryer në këtë procedim penal nga subjekti i rivlerësimit është i mangët dhe i paplotë në ato drejtime, sikurse është gjetur nga prokurori më i lartë, që ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit. Gjithashtu, padijenja e subjektit të rivlerësimit, si për vendimin e shfuqizimit nga prokurori më i lartë, i marrë në zbatim të nenit 24, pika 5 të Kodit të Procedurës Penale, përcjellë me shkresën e datës 15.01.2015, në Prokurorinë Tiranë, si dhe mungesa e dijenisë për vazhdimësinë më tutje të këtij procedimi penal, në të cilin ka qenë

¹⁵ Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të të dhënave nga burime arkivore të KLP-së lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime, për periudhën 2006-2022, mbi ankesën e z. K. S., referuar si praktika nr. {***}, datë 09.07.2014, në rubrikën përkatëse të Raportit të KLP-së për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi, nr. {***} prot., datë 24.01.2023, faqja 21.

¹⁶ Paragrafi 21.8 i vendimit të Komisionit.

prokurori i çështjes (për sa kohë nuk ka referenca për kohën e marrjes nga prokurori tjetër), tregojnë për mungesë të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, që bien nën veprimin e nenit 74, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, të cilat duhen marrë në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me këtë procedim penal.

21.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi shkaku e ankimit duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur se, sipas dijenisë së tij në kohën përkatëse, vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {***}, viti 2013, kishte marrë formë të prerë pa u ankimuar. Vetëm me marrjen në dorëzim të rezultateve të hetimit administrativ, ai u vu në dijeni se kallëzuesi kishte paraqitur një ankesë jashtë afateve pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe se ky i fundit e kishte shfuqizuar vendimin e pushimit, duke urdhëruar vijimin e hetimeve me një prokuror tjetër. Pas kërkesave formale për t'u njohur me aktet, rezultoi se as në sekretari dhe as në arkivën e Prokurorisë Tiranë, nuk gjendet vendimi i shfuqizimit dhe as fashikulli i përcjellë. Sipas informacionit të disponuar, këto akte nuk kanë qenë të aksesueshme as nga Komisioni. Kur vendimi i shfuqizimit dhe fashikulli i përcjellë nuk ekzistojnë në arkivë dhe nuk sigurohen as nga organi që i ka nxjerrë, nuk lejohet nxjerrja e një përfundimi negativ ndaj subjektit të rivlerësimit për mungesë aftësish organizative. Nga përgjigjja nr. {***} prot., datë 23.09.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se procedimi është regjistruar më 03.06.2013 nga prokurori Z. H.; më datë 06.12.2013 është marrë me zëvendësim nga subjekti i rivlerësimit, i cili më datë 13.05.2014 ka vendosur pushimin; më datë 21.01.2015 procedimi i është kaluar për hetim prokurorit J. Z.. Për të njëjtin procedim nuk rezulton vendimmarrje përfundimtare dhe dosja vijon në fazë hetimi. Këto të dhëna zyrtare provojnë ndërprerjen e kompetencës faktike të subjektit të rivlerësimit pas datës 21.01.2015 dhe përjashtojnë çdo përgjegjësi të tij për vijimin e mëtejshëm të hetimit, duke bërë të pajustificuar çdo referim ndaj mangësive organizative, në kuptim të nenit 74, pika 5 e ligjit nr. 96/2016.

21.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, referuar vendimit të prokurorit më të lartë, i cili ka shfuqizuar vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2013, marrë nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se hetimi i kryer është i paplotë në drejtim të pyetjes së personave të përfshirë në ngjarje dhe dëshmitarëve, veprime që edhe pse rezultonin se ishin ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit, është kërkuar të përsëriten. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e dijenisë për vazhdimësinë e këtij procedimi penal, referuar përmbajtjes së shkresës nr. {***} prot., datë 23.09.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ky pretendim është vlerësuar bindës.

22. Në konkluzion, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për çështjet e trajtuara më sipër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke pasur në konsideratë llojin e veprave penale objekt i hetimeve, kohën se kur janë zhvilluar hetimet, raportin e tyre me numrin e përgjithshëm të çështjeve penale që ndjekin mesatarisht prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vlerësoi se problematikat e konstatuara nuk janë në atë masë për t'u konsideruar si mangësi serioze apo

shkelje të rënda në aftësitë profesionale, të tilla që të ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit Dritan Nushi.

B/2 Lidhur me etikën

23. Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim se ndërtimi i një shtese kati + papafingo me sipërfaqe 153,3m², jo në zbatim të normativës ligjore, mbi pasurinë në përdorim të tij “apartament me sipërfaqe 93 m²”, nga vjehri i tij, për një periudhë disavjeçare, në dijeni të subjektit të rivlerësimit, tregon një qasje të caktuar të këtij të fundit në raport me respektimin e ligjit, zbatimi i të cilit është detyrë themelore e një magjistrati, nëpërmjet ushtrimit të funksionit të tij, por jo vetëm. Sjellja e jashtme, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti është objekt rregullimi i normave të etikës së prokurorit dhe pjesë e standardeve që udhëzojnë shembuj më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Në këtë kuptim, kjo çështje, në vlerësim të Komisionerit Publik do të duhet të merret në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

23.1. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me pretendimet mbi cenimin e etikës.

23.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi shkakun e ankimit duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se Komisioneri Publik nuk ka identifikuar dot se cila sjellje konkrete e subjektit të rivlerësimit realizon shkeljen e supozuar, as mekanizimin normativ me të cilin kjo dijeni e thjeshtë do të përktehej në mospërputhje etike. Në mungesë të një përshkrimi të individualizuar të veprimit/vetëpërmbajtjes së subjektit, si dhe të një lidhjeje shkakësore midis kësaj sjelljeje dhe komprometimit të detyrës, pretendimi mbetet thjesht deklarativ. Të dhënat e paraqitura lidhen me ndërtimin e kryer nga vjehri i subjektit të rivlerësimit dhe nuk prekin objektivitetin, pavarësinë, paanësinë apo shmangien e papajtueshmërive në ushtrimin e funksionit nga vetë subjekti i rivlerësimit. Punimet e shtesës së katit janë realizuar në vitet 2009-2010, tërësisht nga babai i bashkëshortes, me profesion inxhinier ndërtimi, përmes shoqërisë së tij të ndërtimit, me mjetet dhe fuqinë punëtore të kësaj shoqërie, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj dhe kërkesa për legalizim është depozituar më datë 27.06.2013, kur objekti ka qenë i përfunduar dhe i banuar. Vetë subjekti, nga qershori 2007 deri në nëntor 2013, ushtronte detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Kavajë, nisej herët në mëngjes dhe kthehej vonë pasdite, kohë kur aktiviteti në kantier kishte përfunduar. Kjo e reduktoi në minimum kontaktin e tij me procesin teknik të punimeve. Në atë periudhë, subjekti i rivlerësimit nuk kishte asnjë mundësi apo kompetencë për të ndikuar në organet e kontrollit të territorit në Tiranë, ai shërbente si prokuror në Kavajë dhe nuk ushtronte autoritet juridiksional apo territorial në Tiranë. Nuk ka pasur asnjë situatë konflikti interesi dhe përgjatë gjithë karrierës së tij nuk ka përdorur dhe as devijuar autoritetin publik në funksion të çfarëdo interesi privat. Kjo tablo faktesh bie ndesh me supozimet se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni apo rol në veprimtarinë ndërtimore të vjehrit të tij.

23.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me pasurinë në përdorim “apartament me sipërfaqe 93 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë dhe shtesë 1

kat+papafingo, me sipërfaqe 153,3 m² ndërtuar mbi pasurinë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, pretendimet e tij, mbi mungesën e dijenisë për ekzistencën apo jo të lejes së ndërtimit për shtesën e katit+papafingo, vlerësohen bindëse, edhe pse subjekti, me njohuri të posaçme në këtë drejtim, duhet të ishte i vëmendshëm për sa parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi, në periudhën e ndërtimit të këtij objekti.

B/3 Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

24. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore, duke e vendosur organin e rivlerësimit në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar pasurinë e paluajtshme “apartament me sipërfaqe 153 m²”, me adresë rruga “{***}”, Tiranë dhe pasuritë të cilat i ka deklaruar si adresa banimi ndër vite, si dhe burimet e ligjshme të krijimit të tyre, çka vlerësohet se duhet analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera në ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, analizohet si më poshtë.

24.1. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ për pasurinë e paluajtshme “apartament me sipërfaqe 153 m²”, me adresë rruga “{***}”, Tiranë, në vendim¹⁷, ka arritur në përfundimin se: [...] referuar fakteve që kjo pasuri është blerë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit me të ardhurat nga puna e tyre dhe nuk u vërtetua që subjekti të ketë kontribuar financiarisht në krijimin e saj; pothuajse i gjithë çmimi i blerjes është paguar që në vitin e parë të subjektit në detyrë nga familja e origjinës së subjektit; kontrata e shitblerjes së apartamentit është lidhur nga nëna e tij, çka e bën atë pronar të vetme mbi këtë pasuri; subjekti ka banuar në apartament për shkak të marrëdhënies familjare vetëm në vitet 2004 - 2005, për një kohë të shkurtër, më pak se dy vjet, si pjesë e familjes së tij të origjinës dhe përpara se të lidhte martesë; subjekti që nga viti 2006 e në vazhdim ka jetuar me bashkëshorten dhe fëmijët e tij në apartamentin e blerë nga vjehri i tij; në këtë apartament kanë banuar dhe vazhdojnë të banojnë pa ndërprerje nëna dhe motra e subjektit - në përfundim të hetimit, Komisioni nuk gjeti asnjë element që e lidh subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri, nuk konstatoi problematika të karakterit ligjor për këtë pasuri dhe nuk ngriti dyshime se ajo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, prandaj vlerësoi të mos hetojë më tej për mundësinë financiare të krijimit të kësaj pasurie nga familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit.

24.2. Komisioneri Publik, në argumentimin e shkakut të ankimit, në kundërshtim të konkluzionit të sipërcituar të Komisionit¹⁸, ka pretenduar se:

a) Sikundër ka rezultuar, në deklaratën e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësi me 1/3 pjesë takuese të tij në apartamentin me sip. 153 m², i pahipotekuar, në Tiranë, në adresën rruga “{***}”. Nuk rezulton që ta ketë deklaruar këtë pasuri në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, si dhe as në atë të vitit 2004 dhe 2005, moment kur shkëputet nga trangu familjar;

b) Sipas aktmarrëveshjes së datës 19.10.2002, akt origjinar i kësaj pasurie, ka rezultuar se shuma 50.000 USD është paguar me lidhjen e saj, në muajin tetor 2002, kohë kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie pune;

¹⁷ Paragrafi 16.12. i vendimit të Komisionit.

¹⁸ Konkluzioni i Komisionit i referuar nga Komisioneri Publik, në ankim, në paragrafin 18.14.

c) Përveç sa më sipër, nga aktet në dosje kanë rezultuar deklaratime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e banimit të tij ndër vite, duke filluar nga deklaratat e parë e vitit 2003 e në vijim, deklaratime që duket se gjejnë reflektim edhe nga akte të tjera të administruara në dosjen e Komisionit gjatë hetimit, në emër të familjarëve të tij.

Sa më sipërtrajtuar, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme, nuk ka qenë koherent në deklaratimet e tij lidhur me vendbanimet. Për më tepër, deklaratimet kontradiktore të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, krahasuar me deklaratimet periodike të tij dhe dokumentacionin e përfituar nga hetimi administrativ mbi vendbanimin e tij dhe familjarëve të tij, krijojnë paqartësi se ku ka banuar subjekti i rivlerësimit ndër vite, duke bërë të pamundur verifikimin e situatës reale.

24.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me këtë pasuri.

24.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare prapësoi shkakun e ankimit lidhur me këtë pasuri, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se nuk ka përfitim të pajustificuar, as mospërputhje materiale midis përdorimit familjar dhe titullit real e, aq më pak, element që të ngrejë dyshim për fshehje apo deklarim të rremë. Dokumentacioni primar është koherent dhe i mjaftueshëm për të provuar se pronësia i përket ekskluzivisht nënës së subjektit të rivlerësimit dhe se referenca e vitit 2010 ka qenë thjesht një pasqyrim i gabuar, i korrigjuar pa vonesë sapo janë sqaruar faktet. Edhe pretendimi për adresat e banimit nuk i reziston provës: lëvizja nga banimi i përkohshëm familjar (2003-2005) te banesa e familjes së re (që prej vitit 2006) shpjegon çdo ndryshim në deklaratime, ndërsa të dhënat e operatorëve publikë dhe aktet noteriale e administrative e konfirmojnë vijimësinë faktike të përdorimit të apartamentit nga nëna dhe motra e subjektit. Pra, nuk ka pasuri të fshehur për t'u gjurmuar, por një pasuri e prindërve me titull të pastër të dokumentuar, jashtë orbitës deklarative të subjektit. Në këto rrethana, detyrimi ligjor për deklarim nuk mund të aplikohet për këtë apartament, sepse subjekti as nuk e zotëron, as nuk e ka në përdorim, në kuptimin e shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe as ka kontribuar në krijimin e tij. Për pasojë, shkaqet e ankimit në këtë pikë janë të pambështetura dhe duhen rrëzuar, duke lënë në fuqi konkluzionin e Komisionit se nuk ekziston asnjë element që ta lidhë subjektin me pasurinë, as ndonjë problematikë ligjore apo paqartësi që të pengojë verifikimin e burimeve. Provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ofrojnë një panoramë të plotë, të verifikueshme dhe koherente të krijimit, financimit dhe formalizimit të pasurisë. Asnjë prej këtyre akteve nuk ngre indicie për kontribut të subjektit, as nuk pasqyrojnë ekzistencë dhurimi/huaje në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe as nuk krijojnë dyshim të arsyeshëm mbi burimin e ligjshëm të pasurisë nga prindërit. Si rrjedhim, nuk lind as detyrimi për verifikim të zgjeruar financiar të prindërve si “persona të tjerë të lidhur”, as bazë për vlerësim negativ në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, çdo rezervë e Komisionerit Publik mbi mundësinë e kontrollit të kësaj pasurie mbetet e pambështetur si faktikisht, ashtu edhe juridikisht.

24.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me apartamentin e banimit me adresë rruga “{***}”, Tiranë, si dhe me adresat e banimit të deklaruara në vite, mbeti e provuar se kjo pasuri është porositur nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, është

shlyer prej tyre në vitet 2002 dhe 2012 dhe është në pronësi të plotë të nënës së tij. Aktet e depozituara gjatë gjykimit në Kolegj konfirmuan qëndrimin e vazhdueshëm të familjarëve të subjektit të rivlerësimit në këtë adresë banimi, çka bën që pretendimet e tij, se nuk gëzon të drejta reale mbi këtë pasuri, të vlerësohen bindëse. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me adresat e tij të banimit ndër vite, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes mbetën të pasakta dhe kontradiktore, por këto pasaktësi çmohet se nuk janë të tilla, që të marrin peshë në vlerësimin përfundimtar të tij.

25. Lidhur me pasurinë “automjetit tip “Daimler Chrysler”, me targë {***}, Komisioneri Publik ka pretenduar, në ankim, se *mosdeklarimi i përdorimit të këtij automjeti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e bën deklarin e subjektit të pasaktë, në kuptim të pikës 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

25.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.11.2016, sipas së cilës, znj. B. N. (motra e subjektit të rivlerësimit), në cilësinë e pronares¹⁹ së mjetit të llojit “autoveturë”, të markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2005, me targa {***}, deklaroi se është dakord dhe autorizon z. Dritan Nushi të përdori automjetin e përshkruar më sipër, në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe jashtë këtij territori pa kufizim (jashtë kufijve), për një afat kohor të pakufizuar. Hetimi i Komisionit, lidhur me të drejtën e përdorimit të subjektit të rivlerësimit mbi këtë automjet, nuk ka vazhduar më tej dhe në vendimin përfundimtar kjo çështje nuk është vlerësuar për t’u trajtuar nga Komisioni.

25.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me këtë pasuri.

25.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi shkakun e ankimit lidhur me këtë pasuri, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se përdorimi i automjetit prej tij ka qenë vetëm i përkohshëm dhe i rastësishëm, pa krijuar raport juridik përdorimi në datën e deklaramit dhe, si i tillë, nuk gjeneron detyrim deklarimi në deklaratën e rivlerësimit.

25.4. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me pasurinë në përdorim “automjet”, tip Daimler Chrysler, me targë {***}, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën bindëse. Subjekti i rivlerësimit dispononte pasuri tjetër të luajtshme “automjet”, në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit dhe nga të dhënat e sistemit *TIMS* nuk rezultuan hyrje-dalje të shpeshta jashtë vendit me këtë automjet, gjatë dhe pas periudhës së plotësimit të deklaratës së rivlerësimit.

26. Në konkluzion, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, problematikat e konstatuara rezultuan të tilla që nuk marrin peshë në vlerësimin tërësor të çështjes.
27. Në përfundim, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur në konsideratë konkluzionet e mësipërme, si dhe faktin se gjatë hetimit administrativ në Komision

¹⁹ Znj. B. N. konfirmohet si pronare e automjetit tip “Daimler Chrysler”, me targë {***} edhe nga të dhënat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të përcjella në Komision.

dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nuk u konstatuan problematika që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në parashikimet e nenit F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi nga Kolegji lënien në fuqi të vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi.

28. Në kushtet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i mjetit procedural të ankimit, ka kërkuar para Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, duke mos e kundërshtuar më atë, tregon se për të nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimuar, duke e lënë në këtë rast ankimin pa objekt. Në vlerësim të trupit gjykues, kjo situatë përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile.
29. Në rrethanat që deduktohet mungesë e interesit të ligjshëm, një vendimmarrje e Kolegjit e ndryshme nga ajo e kërkuar nga ankuesi, teorikisht, do ta bënte vendimin të cenueshëm, nëse do të ankimohej nga subjekti i rivlerësimit.
30. Për sa më sipër, në vlerësim të trupit gjykues, nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt shqyrtimi, për sa kohë ankimi humbi objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit.
31. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pasoja e vetme ligjore për këtë situatë faktike procedurale është pushimi i shqyrtimit në Kolegj të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit me nr. 17/2024, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi, pasi vijimi i gjyqimit për kontrollin e vendimit të Komisionit mbi bazën e një ankimi, të mbetur pa objekt dhe në mungesë të interesit të ligjshëm të ankuesit, do të përbënte cenim të procesit të rregullt ligjor.
32. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen të nevojshëm të deklarojë edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, objekt i ankimit të Komisionerit Publik. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se në zbatim të parashikimeve të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenet 1, pika 2 dhe 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe nenet 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. 735, datë 31.01.2024, i Komisionit, ndaj të cilit ishte ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 17/2024, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.12.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi